



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë/ Ministarstvo Zdravstva/ Ministry of Health
Agjencioni i Financimit Shëndetësor/ Agencija za Financiranje Zdravstva/Health Financing Agency

SHPALLJA PËR AVANCIM

Departamenti:	Shërbimeve Shëndetësore
Titulli i vendit të punës:	Udhëheqës i Divizionit për Trajtim Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike
Kategoria funksionale/Grada:	6/ Kofi 9
Raporton:	Udhëheqësi i Departamentit
Nr. Referencës:	MSh-000/00/16

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

1. Udhëheq procesin e pranimin e të gjithë lëndëve/aplikimeve nga palët.
2. Mban regjistër manual dhe elektronik, për të gjitha aplikimet, lëndët që kanë kaluar nga komisioni i shkallës së parë, shkallës së dytë, për lëndët që financohen nga programi për Trajtim Mjekësor jashtë Institucioneve Shëndetësore Publik (TMJISHP) si dhe regjistrin për listën e pritjes sipas llojit dhe natyrës së sëmundjeve.
3. Përgatit raporte të rregullta periodike për Drejtorin e Departamentit, dhe sipas kërkesës edhe raporte specifike.
4. Përgatit analiza profesionale të rregullta tre mujore, për patologjitë e ndryshme që nuk trajtohen nga Institucionet Shëndetësore Publike;
5. Bashkëpunon dhe komunikon në mënyrën më të mirë të mundshme me palët, gjatë ofrimit të ndihmës për aplikime.
6. Bashkëpunon ngushte me Komisionin, përkatësisht Bordin për TMJISHP, duke u siguruar atyre kushte maksimale për punë.
7. Në bashkëpunim me Departamentin për Shërbime Shëndetësore bën monitorim të planifikuar në Institucionet Shëndetësore që kanë trajtuar pacientët në kuadër të programit për TMJISHP.
8. Në bashkëpunim me Departamentin e Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme bën barazimin me institucionet shëndetësore që kanë trajtuar pacientë përmes Divizionit për TMJISHP.
9. Hulumton dhe monitoron rastet në baza të rregullta dhe ad-hoc, si në Institucionet Shëndetësore Publike dhe në ato Private , brenda dhe jashtë vendit.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar brenda institucionit Ministria e Shëndetësisë, dëshmi e përvojës se punës jashtë institucioneve publike ti bashkëngjitet edhe pasqyra e llogarisë nga Trusti, dokumentet dhe dëshmitë ti bashkëngjiten aplikacionit kopje;

Shkollimi i kërkuar: Diplomë Universitare në Mjekësi, Juridik, Ekonomik, ose Menaxhment.

Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Minimum 5 vite përvojë pune profesionale,
- Njohuri dhe përvojë substanciale lidhur me shpenzimet e parasë publike
- Aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse në menaxhim;

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin: Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr. 21/2012 Për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë dhe Rregulloren Nr. 02/2010 Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kohëzgjatja e emërimit: Nëpunës i karrierës.

Data e publikimit dhe e mbylljes së shpalljes: 00/00/2016 deri 00/00/2016

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren në recepcion dhe dorëzohen në zyrën nr. 23 , Në aplikacion duhet të cekët qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës. Kontaktet me telefon mund ti bëni në 24-073.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

18/04/2016

Udhëheqës i Divizioneve për Burime Njerëzore
Jahë Gecaj _____